

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Tre operacione në Kukës e Tropojë/ 3 në pranga, sekuestrohen armë dhe 42 bimë kanabis - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/tre-operacione-ne-kukes-e-tropoje-3-ne-pranga-sekuestrohen-arme-dhe-42-bime-kanabis/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 07:15:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 07:10:27 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	56334f04ea93cadb2197bbbbe48f6c9933599938075444a481017e59eca8f8ba
TEKSTI	d689216121629bd9ff3cb5efbd9741c21ae3f3c70c290a250e882ef4eb6edaba
PAMJA	7092e14131f8cd668b916cff4a093ec346ff7ed1fe6480daa75ff956d40c7885

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c81c6ef04aa93bbf941daa2c0b2022cd04af4a77d2bc8817c607efbb696b3dfe
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c6e9ce599dcf050571ac11f5fe8a3879623b3af12e442f4fee76de6471dba328
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c81c6ef04aa93bbf941daa2c0b2022cd04af4a77d2bc8817c607efbb696b3dfe>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

Tre operacione në Kukës e Tropojë/ 3 në pranga, sekuestrohen armë dhe 42 bimë kanabis

by Sport Sport — September 28, 2026 in Aktualitet, Kronikë

0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Tre operacione policore të zhvilluara gjatë 24 orëve të fundit në Kukës dhe Tropojë kanë çuar në arrestimin e tre personave, ndërsa janë sekuestruar armë zjarri, municion dhe bimë narkotike. Gjithashtu, policia ka zbardhur dy raste të vjedhjes me thyerje.

Në Tropojë, në kuadër të operacionit "Befasia", u arrestua 45-vjeçari E. M., banues në Markaj. Gjatë kontrollit të banesës, në zbatim të një vendimi gjykate, policia gjeti dhe sekuestroi një armë zjarri automatike dhe municion luftarak.

Po në Tropojë, gjatë operacionit "Weekend", u arrestua në flagrancë 38-vjeçari S. H., i dyshuar për kultivim të bimëve narkotike dhe armëmbajtje pa leje.

Sipas policisë, gjatë kontrollit në një zonë të pyllëzuar në territorin e Njësisë Administrative Tropojë e Vjetër, shërbimet konstatuan 38-vjeçarën rreth 50 metra larg një parcele ku ishin kultivuar 42 bimë kanabis. Nga veprimet hetimore dyshohet se bimët ishin kultivuar prej tij.

Gjatë kontrollit fizik, atij iu gjet një pistoletë me krehër dhe 9 fishekë, ndërsa në banesë u sekuestruan një armë gjahu, municion dhe një thikë.

Zbardhen dy vjedhje në Kukës

Ndërkohë, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Kukës, në bashkëpunim me strukturat e Policisë Durrës, kanë dokumentuar dy raste të vjedhjes me thyerje, të një automjeti dhe të një lokali.

Në kuadër të operacionit "Hija", u arrestua 31-vjeçari I. J., banues në Krumë, Has. Sipas policisë, në orët e para të mëngjesit të 26 shtatorit, ai dyshohet se ka vjedhur me thyerje një automjet dhe më pas ka hyrë në një lokal, prej nga ka marrë sende, përfshirë një aparat celular.

Si prova materiale u sekuestruan automjeti i vjedhur, telefoni dhe një thikë.

Policia bën me dije se po vijon hetimet për dokumentimin e rasteve të tjera të vjedhjeve që dyshohet se janë kryer nga 31-vjeçari në Has dhe Durrës.

Materialet procedurale i janë referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës për veprime të mëtejshme.

TË FUNDIT

Tre operacione në Kukës e Tropojë/ 3 në pranga, sekuestrohen armë dhe 42 bimë kanabis

SEPTEMBER 28, 2026

Kthjellime dhe vranësira kalimtare/ Parashikimi i motit për sot, 28 shtator 2026

SEPTEMBER 28, 2026

Skandali tek SHISH/ Presidenti Begaj mbledh sot Këshillin e Sigurisë Kombëtare

SEPTEMBER 28, 2026

Horoskopi për sot, 28 shtator 2026/ Dashuria, financat dhe surprizat për 12 shenjat

SEPTEMBER 28, 2026

Alarm i kuq në Meksikë, uragani "Polo" pritet të prekë tokën të hënën mbrëma

SEPTEMBER 27, 2026

Përkallëzohen tensionet Izrael-Turqi/ Netanyahu urdhëron përgatitjen e çështjes kundër Erdogan në Hagë

SEPTEMBER 27, 2026

Vuçić jep dorëheqjen si president i Serbisë

SEPTEMBER 27, 2026

"Nesër më shumë"/ Mbyllet protesta e 120 kundër Ramës në Tiranë

SEPTEMBER 27, 2026

Asnjë shtrëngim duarsh, kokat ulur dhe shirita të zinj, Irlanda e kthen ndeshjen me Izraelin në një deklaratë simbolike

SEPTEMBER 27, 2026

Kumbarët e kokainës/ Nga Kolumbia e Ekuadori në Europë, si u trafikuan mbi 50 tonë drogë

SEPTEMBER 27, 2026



Sport Sport

report.al


REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparenca dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

Aktualitet
OP-ED
Politike
Rajon
Showbiz
Sociale
Shëndet
Sport

MË TË KLIKUARAT



Makina 150 mijë euro e Grida
Dumës, dhuratë nga Ergys Agasi?!
Ja çfarë thonë Lolita dhe Elvi Fundo

01

0 SHARES



Shkarkohet Ilir Topi/ Ish-drejtesja e CFO
Pharma, Rexhina Bici pritet të drejtojë Fondin e
Sigurimeve

0 SHARES



Gazetari trondit me deklaratën: Dyshime të forta
për lidhjen e Neritan Nallbatit me Ergys Agasin

0 SHARES